

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

ADRESA: BELSH,

bashkiabelsh@hotmail.com

Nr. 1180 Prot.

Data: 02/04/2025

V E N D I M

Nr. 205 Date 02.04.2025

**“Për miratimin e vendeve publike për afishimin e materialeve
propagandistike nga subjektet zgjedhore”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në zbatim të Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Për Kodin Zgjedhor”, Dekretit të presidentit nr.399 datë 05/12/2024 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin që do të mbahen më 11 Maj 2025, Udhëzimit nr.6 datë 23.03.2021 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, si dhe të shkresës nr. 2210 datë 27.03.2025 ardhur nga KQZ-ja për këtë qëllim:

V E N D O S A

1. Të miratojë vendet publike “ **Objektin ish-Vatra e Kulturës në Belsh (faqet e murit anësore nga rruga dhe faqja ballore nga karburanti)**” dhe “**Muri mbajtës i rrugës kryesore poshtë Lokalit të Agron Hysa**” për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Policia Bashkiake.

KRYETARI

Arif TAFANI

